

Shkodër, 19 Dhjetor / December 2016

Vlorë, 20 Dhjetor / December 2016

Durrës, 21 Dhjetor / December 2016

Berat, 22 Dhjetor / December 2016

"KORRUPSIONI ZGJEDHOR

SI RREZIK PËR DEMOKRACINË SHQIPTARE DHE ROLI I PJESËMARRJES QYTETARË"

"ELECTORAL CORRUPTION

JEOPARDIZING ALBANIAN DEMOCRACY AND THE ROLE OF CITIZENS' PARTICIPATION"

NJOFTIM

Organizata KRIIK ALBANIA, në bashkëpunim me Koalicionin e Vëzhguesve Vendorë, prej ditës së hënë datë 19 Dhjetor, do të organizojë katër tryeza të rrumbullakëta me temë "Korrupsioni zgjedhor si rrezik për Demokracinë shqiptare dhe roli i pjesëmarrjes qytetare" në qytetet Shkodër, Vlorë, Durrës dhe Berat, respektivisht në datat 19, 20, 21 dhe 22 Dhjetor 2016.

Kjo nismë është pjesë e fushatës advokuese në adresim të korrupsionit zgjedhor dhe nxitjes së demokracisë së drejtëpërdrejtë, e organizuar nga KRIIK në bashkëpunim me Koalicionin e Vëzhguesve Vendorë (KVV), e cila është mbështetur financiarisht nga **Ambasada e Zvicrës në Tiranë** dhe **Ambasada e Vendeve të Ulëta në Tiranë**.

Qëllimi i fushatës është ngritja e shqetësimit për të gjitha format dhe shfaqjet e deformimit të vullnetit popullor në proceset zgjedhore, si dhe në periudhën midis tyre. Gjithashtu, një nga objektivat kryesorë është sjellja në vëmendje dhe hapja e diskutimeve rreth proceseve me ndikim madhor në çështjet zgjedhore apo të demokracisë në përgjithësi, si reforma zgjedhore, financat e partive politike apo dekriminalizimi. Më konkretisht, rreth shkaqeve të dështimit të reformës zgjedhore, mungesës së kontrollit të financave të partive politike dhe mungesës së efikasitetit të procesit të dekriminalizimit.

Përgjatë tryezave do të bëhet prezantimi i elementëve kryesorë që përbëjnë korrupsionin zgjedhor dhe, përpos informimit mbi to, do të sillen një qasje më e plotë dhe e thellë e fenomenit të korrupsionit zgjedhor, veçanërisht për sa i përket **çështjeve të administrimit zgjedhor, drejtësisë zgjedhore dhe financave të partive politike**, duke evidentuar përgjatë çdo prezantimi apo diskutimi hapësirat dhe domosdoshmërinë për një rol proaktiv të të gjithë aktorëve të shoqërisë dhe vetë qytetarëve, si dhe diskutuar mbi mënyrat e përballjes së këtij fenomeni.

Programi i tryezave të rrumbullakëta do të jetë i ndarë në dy sesione kryesorë. Sesioni i parë do t'i kushtohet prezantimit teorik të fenomenit të korrupsionit zgjedhor, si dhe zhvillimeve institucionale dhe politike në muajt e fundit. Sesioni i dytë do t'i kushtohet diskutimeve me pjesëmarrësit rreth çështjeve të diskutuara në sesionin e parë, pasqyrimin në nivel lokal të fenomenit si dhe do të jepet hapësira për diskutime të tjera të lira të pjesëmarrësve rreth tematikës.

Diskutimet dhe shqetësimet e dala përgjatë tryezave të rrumbullakëta do t'i përcillen Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore si dhe aktorëve të rëndësishëm politikë e institucionalë, ose edhe Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore. Këtij të fundit lidhur me amendime të tjera ligjore që mund të ndërmerren për përmirësimin e procesit të ardhshëm zgjedhor dhe adresimin konkretisht të problematikave që përbëjnë dhe ushqejnë fenomenin.

Të ftuar dhe pjesëmarrës në këto tryeza të rrumbullakëta do të jenë përfaqësues të organizatave joqeveritare lokale, të partive politike, institucioneve përgjegjëse, të mediave lokale, si dhe të rinj, studentë, profesionistë apo persona të tjerë të interesuar në çështjet zgjedhore dhe të mirëfunksionimit të demokracisë.



në bashkëpunim me / in collaboration with:



Koalicioni i
Vëzhguesve
Vendorë

Me mbështetjen financiare të:
With the financial support of:

Ambasadës së Zvicrës në Tiranë
Embassy of Switzerland in Tirana



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Embassy of Switzerland in Albania

Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë
Embassy of the Kingdom of the Netherlands in Tirana



Kingdom of the Netherlands

Shkodër, 19 Dhjetor / December 2016

Vlorë, 20 Dhjetor / December 2016

Durrës, 21 Dhjetor / December 2016

Berat, 22 Dhjetor / December 2016

“KORRUPSIONI ZGJEDHOR

SI RREZIK PËR DEMOKRACINË SHQIPTARE DHE ROLI I PJESËMARRJES QYTETARE”

“ELECTORAL CORRUPTION

JEOPARDIZING ALBANIAN DEMOCRACY AND THE ROLE OF CITIZENS’ PARTICIPATION”

Tematikat e tryezës:

1. *Tranzicioni i gjatë i demokracisë shqiptare dhe humbja e besimit.*
2. *Kërcënimi i kapjes së shtetit nga interesa të panjohura dhe të paligjshme.*
3. *Korrupsioni zgjedhor dhe tre dimensionet e proceseve zgjedhore.*

PROGRAMI

- 09:45 - 10:00 Regjistrimi i pjesëmarrësve.
- 10:00 - 10:10 Fjala e hapjes, moderator përfaqësues i KRIIK / KVV.
- 10:10 - 10:40 “Mbi korrupsionin zgjedhor”, përfaqësues i KRIIK / KVV.
- *Deformimi i vullnetit demokratik, çfarë është korrupsioni zgjedhor, si mund të deformohet vullneti demokratik, besimi qytetar tek forca e votës, sa ndryshim bën një votë.*
 - *Administrimi zgjedhor, menaxhimi i procesit zgjedhor nga institucionet përgjegjëse si Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor, e të tjerë.*
 - *Financat e partive politike, kush është rregullimi ligjor, sa efikas ka qenë deri më sot kuadri ligjor, kush janë boshllëqet ligjore që lënë vend për abuzivizëm, si ndikojnë financat e partive në kapjen e shtetit.*
 - *Drejtësia zgjedhore, lufta ndaj blerjes së votës dhe ndaj përdorimit të administratës publike, roli i institucioneve përgjegjëse, forcimi i institucioneve për të qendruar larg presionit politik, roli i qytetarëve në forcimin e institucioneve dhe investimi i tyre.*
- 10:40 - 11:20 “Reformat dhe proceset institucionale”, përfaqësues i KRIIK / KVV.
- *Dekriminalizimi, përcaktimet e ligjit, institucionet përgjegjëse, ecuria deri më sot, kush janë sfidat në zbatimin e tij.*
 - *Reforma Zgjedhore, ecuria deri tani e reformës, dështimi i deri tanishëm i këtij procesi, çështjet e rëndësishme për t’u adresuar.*
 - *Zgjedhjet e 18 Qershorit 2018, konteksti politik, pesha në Reformën në Drejtësi, problematikat që mund të shfaqen, pasiguritë për zgjedhjet e ardhshme, mekanizmat që mund të përdoren nga qytetarët.*
- 11:20 – 12.20 Shkëmbime opinionesh dhe diskutime të lira nga pjesëmarrësit.
Hapja e sesionit me një prezantim të shkurtër mbi “Korrupsioni zgjedhor dhe sfida në nivel lokal”.
- 12:20 - 12:30 Konkluzione.
- 12:30 Mbyllja e aktivitetit / Kafe.



në bashkëpunim me / in collaboration with:



**Koalicioni i
Vëzhguesve
Vendorë**

Me mbështetjen financiare të:
With the financial support of:

Ambasadës së Zvicrës në Tiranë
Embassy of Switzerland in Tirana



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Embassy of Switzerland in Albania

Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë
Embassy of the Kingdom of the Netherlands in Tirana



Kingdom of the Netherlands